



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2022-14

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Roumen Nenkov
Gjykatës Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Titulli i lëndës: Kërkesë Referuese e Kadri Veselit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit mbi Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara

Klasifikimi: Publik

Vendim për Parashtrime të Mëtejshme

Parashtruesit

Kadri Veseli

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

I. KËRKESË REFERUESE

1. Më 28 shkurt 2022, z. Kadri Veseli ("parashtruesi") dorëzoi një Kërkesë Referuese në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, që mban datën 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese"),¹ në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"). Parashtruesi përfaqësohet nga z. Ben Emerson dhe z. Endru Strong.
2. Në Kërkesën Referuese parashtruesi ngre disa ankesa kushtetuese në lidhje me procedurat penale kundër tij që po zhvillohen para Dhomave të Specializuara.
3. Së pari, parashtruesi ankohet se në bazë të Ligjit të miratuar në vitin 2015, ai akuzohet për krime sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare ("DZN"). Sipas parashtruesit, një zbatim i tillë i drejtpërdrejtë i DZN-së shkel të drejtat e tij të garantuara nga: (i) neni 19 i Kushtetutës, i cili, sikundër argumenton parashtruesi, përjashton, si parim i përgjithshëm, mundësinë e ngritjes së akuzave për krime sipas DZN-së;² (ii) neni 33(1) i Kushtetutës, neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"), dhe neni 15 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDTCP"), që ndalon zbatimin prapaveprues të së drejtës penale;³ dhe (iii) së bashku me nenin 7 të Konventës, – neni 24 i Kushtetutës, neni 14 i Konventës dhe neni 26 i KNDTCP-së.⁴ Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkon Dhomës që t'i shpallë jokushtetuese dhe rrjedhimisht të pavlefshme dispozitat përkatëse të Ligjit të cilat parashikojnë, dhe për aq sa parashikojnë, zbatimin e drejtpërdrejtë të DZN-së,⁵

¹ KSC-CC-2022-14, F00001, Kërkesë Referuese e Kadri Veselit kundër "Vendimit mbi Apelet kundër 'Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara'", publik, 28 shkurt 2022, me Shtojcën 1, publike.

² Kërkesa Referuese, para. 7(a), 19, 22, 31(a), 91(a).

³ Kërkesa Referuese, para. 7(b), 33, 48(a), 91(b).

⁴ Kërkesa Referuese, para. 7(c), 64(a), 91(c).

⁵ Kërkesa Referuese, para. 24, 31(b), 48(b), 64(b), 91(d).

4. Së dyti, parashtruesi ankohet se po ndiqet penalisht në bazë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP") dhe ndalimit të paligjshëm apo arbitrar, kur asnjëra prej tyre nuk përcaktohet shprehimisht në Ligj. Rrjedhimisht ndjekja penale e tij bazuar në NKP dhe/ose ndalim të paligjshëm apo arbitrar është në shkelje të neneve 33 dhe 55 të Kushtetutës.⁶

5. Së fundi, parashtruesi thotë se ndjekja e tij penale bazuar në formën e zgjeruar të NKP-së, ndalimin e paligjshëm apo arbitrar, dhe/ose zhdukjen me forcë është në shkelje të parimit *nullum crimen sine lege* sipas nenit 33 të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës, dhe nenit 15 të KNDCP-së, duke qenë se ato nuk përbënin krime sipas DZN-së gjatë vitit 1998.⁷

6. Në lidhje me ankesat e mësipërme kushtetuese, nga Kërkesë Referuese del se më 15 mars 2021, parashtruesi dorëzoi një mocion paraparak, me të cilin kundërshton juridiksionin e Dhomave të Specializuara lidhur me akuzat penale në fjalë.⁸ Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë mocionin paraparak të parashtruesit.⁹ Më 27 gusht 2021, parashtruesi apeloj vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁰ Më 23 dhjetor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e parashtruesit.¹¹ Lidhur me këtë, parashtruesi parashtron se nuk i mbetet mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion.¹²

⁶ Kërkesa Referuese, para. 7(d), 66, 70-72, 91(e).

⁷ Kërkesa Referuese, para. 7(e), 88, 91(f).

⁸ Shih, për shembull, Kërkesa Referuese, para. 17, 65, 74, që i referohet KSC-BC-2020-06, F00223, Mocion Paraparak i Mbrojtjes së Kadri Veselit për kundërshtimin e juridiksionit të DHSK-së, publik, 15 mars 2021.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 22 korrik 2021.

¹⁰ Kërkesa Referuese, para. 8, që i referohet KSC-BC-2020-06, IA009, F00010, Apeli i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 27 gusht 2021, me Shtojcat 1-5, publike.

¹¹ Kërkesa Referuese, para. 8, që i referohet KSC-BC-2020-06, IA009, F00030, Vendim mbi Apelet kundër "Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara", publik, 23 dhjetor 2021.

¹² Kërkesa Referuese, para. 13.

II. PARASHTRIME TË MËTEJSHME

7. Lidhur me shqyrtimin e Kërkesës Referuese, Dhoma vëren se në përputhje me rregullën 15(2) të Rregullores së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja"), Paneli mund të kërkojë informacion apo parashtrime shtesë, sipas nevojës, në lidhje me Kërkesën Referuese. Sipas rregullës 15(3), çdo përgjigje urdhëruar prej Panelit dorëzohet brenda afatit të përcaktuar nga Paneli. Gjithashtu, sipas nenit 35(2)(i) të Ligjit, kur kërkesa referuese ka të bëjë me ndjekjen e një aktakuze të ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), ZPS-ja ka kompetencë t'i përgjigjet kërkesës referuese.

8. Mbështetur në sa më sipër, Dhoma e gjen me vend të ftojë ZPS-në dhe parashtruesin të dorëzojnë parashtrime me shkrim, në rast se dëshirojnë, lidhur me Kërkesën Referuese. Në përputhje me rregullën 15(2) të Rregullores, Dhoma e gjykon të nevojshme që parashtrimet me shkrim t'u përgjigjen pyetjeve konkrete që u drejtohen në këtë vendim. Pas dorëzimit të parashtrimeve me shkrim nga ZPS-ja, parashtruesi mund të dorëzojë parashtrime me shkrim lidhur me pyetjet e bëra në këtë vendim dhe/ose të komentojë mbi parashtrimet me shkrim të ZPS-së. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se nuk do të marrë parasysh asnjë parashtrim që nuk është kërkuar prej saj.

9. Dhoma përsërit se ky vendim, përfshirë pyetjet konkrete drejtuar ZPS-së dhe parashtruesit, nuk paragjykojnë vendimin që do të marrë ajo lidhur me Kërkesën Referuese, përfshirë çdo konstatim që mund të bëjë ajo në lidhje me pranueshmërinë apo themelësinë e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli i Gjykatës Kushtetuese

1. *Fton* ZPS-në dhe parashtruesin të dorëzojnë parashtrime me shkrim, në rast se dëshirojnë, në lidhje me Kërkesën Referuese, ku t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:
 - a. A është Kërkesa Referuese e pranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit, dhe rregullave 14 dhe 20 të Rregullores?
 - b. A mundet parashtruesi, në fazën aktuale të procesit penal kundër tij dhe në mungesë të vendimit të fajësisë, të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të pretenduar të nenit 33(1) të Kushtetutës, nenit 7 të Konventës dhe nenit 15 të KNDCP-së?
 - c. Duke qenë se procesi penal kundër parashtruesit është në vazhdim e sipër, a ka megjithatë të drejtë parashtruesi të paraqitë ankesa mbështetur në nenet 19, 24 dhe 33(1) të Kushtetutës, nenet 7 dhe 14 të Konventës dhe nenet 15 dhe 26 të KNDCP-së, para trupit gjykues dhe, më pas, sipas rastit, para Panelit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 46 të Ligjit, dhe para Panelit të Gjykatës Supreme, sipas nenit 47 ose nenit 48(6)-(8) të Ligjit? A duhet që të shterohen këto mjete ligjore për qëllimet e nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit?
 - d. A munden Dhomat e Specializuara të zbatojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare? A bëhen shkas ankesat e parashtruesit lidhur me zbatimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare për krijimin e përshtypjes për shkelje të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës?
2. *Urdhëron* që, në rast se ZPS-ja dëshiron të paraqitë parashtrime me shkrim për pyetjet e mësipërme, këtë duhet ta bëjë deri më **29 mars 2022**; dhe në rast se parashtruesi dëshiron të paraqitë parashtrime me shkrim për pyetjet e mësipërme dhe/ose komente për parashtrimet me shkrim të ZPS-së, nëse ka, këtë duhet ta bëjë deri më **5 prill 2022**;

3. *Urdhëron* që parashtrimet me shkrim të ZPS-së nuk duhet t'i kalojnë 20 faqe; ndërsa parashtrimet me shkrim të parashtruesit nuk duhet t'i kalojnë 15 faqe.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland

Kryegjykatës

Hartuar në anglishte të martën, 15 mars 2022

Hagë, Holandë